

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ANGEL LED SERVICE” SHPK**

Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Leopoldo D’Angelo**, shtetas italian, i datëlindjes 31.01.1984, lindur në Napoli dhe banues ne Rrugen Oberdan Nr.37/B, Pozzuoli, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit italiane Nr. AY7833624.

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 27.09.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

***Emri***

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “ANGEL LED SERVICE” shpk Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

Shoqëria tregtare “ANGEL LED SERVICE” SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***


3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ANGEL LED SERVICE” shpk, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqiperi.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

**Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:** Sherbim konsulence ne investime jashtë dhe brenda vendit, shitblerje e pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme, investimeve publike dhe private. Sherbime konsulence ne fushen e kerkime per studime investimesh, kerkime dhe analize tregu per investim, konsulence marketingu online-off-line. Konsulence e investime strategjike dhe makroekonomike, konsulence ndertim-zbatim e mirembajtje rrjeti teknologjisë. Konsulence ne fushen e cibercrime. Konsulence marketingu dhe reklamimi. Kerkimet e tregut, identitikimin e konkurrences dhe gjetjen e konsumatoreve. Zhvillim dhe menaxhim softuer. Kerkim tregu për klientë të rinj dhe furnizues të brendshëm. Shitjen e hapësirave publicitare per publikimet e veta dhe per llogari te te treteve, edhe nepermjet agjencive dhe ose shoqerive te tjera. Shoqeria mund te kryeje menaxhimin e buxheteve publicitare. Ndërmjetësimi ne fushen e marketing online dhe offline, per blerje jashte dhe brenda vendit per individ dhe biznese, menaxhim per llogari te te treteve e marredheniet me publikun, ndermjetesim per llogaritjen dhe rekuperimin e borxheve te keqija, ndermjetesime legale per palet ne konflikt ose jo. Projektimi, idealizimi dhe realizimi i krijimeve website, rekomandime përmes sistemit kompjuterik, krijimi i programeve kompjuterike, aktivitete të tjera të lidhura për IT, përpunimin e të dhënave kompjuterike. Kryrjen e aktiviteve konsultative dhe koordinative teknike, financiare dhe administrative. Krijimi, zhvillimi idhe realizimi i softwareve dhe sherbimeve telematik. Hulumtim dhe studim për nxitjen e tregtisë ndërkombëtar, për nxitjen dhe negocimin e investimeve te huaja ne vend, për nxitjen e projekteve të zhvillimit ekonomik , në bujqësi, në ndërtim, në Industri, në teknologji, në infrastrukturë, në turizem etj. Fushatave promocionale dhe përfshirjen e investitorëve vendas dhe të huaj në biznes kombetar dhe nderkombëtar.



**NENI 5**

***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**

***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “ANGEL LED SERVICE” shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**

***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “ANGEL LED SERVICE” shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

**NENI 8**

***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ANGEL LED SERVICE” shpk është 100.000 (njqindmije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetem **Z. Leopoldo D’Angelo**.

**NENI 9**

***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**

***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Z. Leopoldo D’Angelo**.

**NENI 11**

***Sekreti tregtar***

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “ANGEL LED SERVICE” shpk përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**

***Mosmarrëveshjet***

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Leopoldo D’Angelo**

